



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 599/6 Prot.

Tiranë, më 26.09.2023

V E N D I M

Nr. 189, Datë 26.09.2023

Bazuar në ligjin Nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O N :

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar ankesën Nr. 156 regj, datë 06.10.2022, të paraqitur nga z.A.Z, kundër Bashkisë Fier, me pretendimin për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”. Me vendimin nr.72, datë 15.05.2023, Komisioneri ka disponuar në lidhje me çështjen, duke vendosur:

1. Konstatimin e diskriminimit të ankuesit A.Z për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e Bashkisë Fier.
2. Në referim të pikës 1, Bashkia Fier, të marrë masa të menjëhershme:
 - a. Për të trajtuar procesin e përfitimit të shërbimit rezidencial të kujdesit shoqëror pranë Shtëpisë së të Moshuarve Fier për ankuesin A.Z.
 - b. Për të asistuar ankuesin A.Z në çdo hap të procesit të përfitimit të shërbimit.
 - c. Për të shmangur çdo sjellje diskriminuese në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror bazuar në aftësinë e kufizuar të personave që duan të përfitojnë nga këto shërbime.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Bashkia Fier, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Komisioneri rekomandon Shërbimin Social Shtetëror, që bazuar në kompetencat e tij ligjore, të marrë masa për të udhëzuar dhe asistuar të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, me qëllim shmangien e praktikës përjashtuese ndaj personave me aftësi të kufizuar për të përfituar nga shërbimet rezidenciale të kujdesit shoqëror, për të moshuarit.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

Rezulton e provuar nga lajmërim marrja e shërbimit postar se, Bashkia Fier ka marrë dijani për vendimin në datën 16.05.2023.

Bazuar në nenin 33, pika 11, të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar (LMD), përcaktohet se : “11. Nëse komisioneri urdhëron rregullime ose masa, subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se subjekti, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, komisioneri vendos masë për ndëshkimin me gjobë për subjektin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni.”

Me shkresën nr. 4186/1 prot datë 16.05.2023 (administruar pranë Komisionerit me nr.599/3 prot datë 07.06.2023), Bashkia Fier ka raportuar para Komisionerit se: “Nga ana e Bashkisë Fier në asnjë rast nuk vërejmë diskriminimin e ankuesit për shkak të aftësisë së tij të kufizuar. Por duhet qartësuar statusi i PAK i grupit I (fizik, mendor, sensor) me atë të grupit të II. Nga ana jonë është sqaruar hollësisht për procedurën dhe dokumentacionin ligjor për shqyrtimin e kërkesës së PAK, z. A.Z për pranim në Shtëpinë e të Moshuarve Fier. Edhe pse është rekomanduar të dorëzohet dokumentacionin e përcaktuar ligjërisht si dhe është ndihmuar nga punonjësja sociale e Njesisë Administrative ku z. Z. ka vendbanimin, akoma nuk është dorëzuar ky dokumentacion. Saktësojmë se vetëm pas këtij dorëzimi, është Komisioni i Vlerësimit të Nevojave të Referimit të Rastit që do të vlerësojë e përgatisë relacionin përkatës, që do t’i bashkëngjitet projekt-vendimit të Këshillit të Bashkisë. Edhe Këshilli i Bashkisë Fier, organi që merr vendimin nëse duhet të miratohet kërkesa ose jo”.

Referuar përgjigjes së mësipërme, Komisioneri vlerëson se, Bashkia Fier nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e vendimit nr.72, datë 15.05.2023, të Komisionerit. Përgjigja e dërguar nga ana e Bashkisë Fier, nuk përmban asnjë masë të ndërmarrë prej saj pas vendimit nr.72, datë 15.05.2023, nëpërmjet të cilit Komisioneri ka konstatuar se, me sjelljen e saj, Bashkia Fier, e ka diskriminuar ankuesin A.Z. Pas vendimarrjes së Komisionerit në lidhje me konstatimin e faktit të diskriminimit

të ankuesit A.Z, nëse Bashkia Fier nuk është dakort me këtë përfundim, gëzon të drejtën e ankimit në gjykatë sipas disponimit të bërë edhe në vendimin e Komisionerit.

Sipas shkresës “*Kthim përgjigje*” nr.12593/1 prot datë 19.09.2023, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, nuk rezulton që Bashkia Fier të ketë paraqitur kërkesë padi pranë kësaj gjykate për kundërshtimin e vendimit nr.72, datë 15.05.2023, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Neni 33, pika 11, të ligjit nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar vendos dy lloj detyrimesh ndaj subjektit të gjetur përgjegjës për sjelljen diskriminuese me vendimin e Komisionerit. *Së pari*, subjekti ka detyrimin për të raportuar para Komisionerit brenda një afati kohor të caktuar, që është 30 ditë nga marrja dijani për vendimin, dhe *së dyti*, subjekti duhet të raportojë në lidhje me masat e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Përdorimi i lidhëzës “*ose*” të përdorur në fjalinë e dytë, të pikës 11, të nenit 33, të ligjit nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar në të cilën shprehimisht përcaktohet se: “*Në rast se subjekti, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, komisioneri vendos masë për ndëshkimin me gjobë për subjektin kundër të cilit është paraqitur ankesa*”, qartëson më tej, dy llojet e ndryshme të detyrimeve që vendosen ndaj subjektit të gjetur përgjegjës për sjelljen diskriminuese. Në këtë kuptim, Komisioneri vendos masë për ndëshkimin me gjobë të subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa, në dy situata: *Së pari*, kur subjekti nuk raporton brenda afatit kohor prej 30 ditësh, nga marrja dijani për vendimin e Komisionerit dhe *së dyti*, subjekti, pavarësisht se ka raportuar brenda afatit 30 ditor, nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e vendimit të Komisionerit.

Informimi i Komisionerit nga ana e subjektit të gjetur përgjegjës për sjelljen diskriminuese, në rastin konkret Bashkia Fier, nuk e përjashton këtë subjekt nga detyrimi ligjor, i përcaktuar në nenin 33, pika 11, të ligjit nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, pasi Bashkia Fier, në cilësinë e subjektit të gjetur përgjegjës për sjelljen diskriminuese, nuk ka marrë masa për zbatimin e vendimit nr.72, datë 15.05.2023, të Komisionerit.

Në këto kushte, rezulton se, Bashkia Fier, nuk ka përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar nga neni 33, pika 11, të ligjit nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, pasi nuk ka marrë masa për zbatimin e vendimit nr.72, datë 15.05.2023. Ky mosveprim, kjo mospërmbushje e këtij detyrimi ligjor, në bazë të nenit 33, pika 13, të ligjit të sipërpërmendur, shoqërohet me marrjen e masave administrative, gjobë. Për personat juridik, siç është në rastin konkret Posta Shqiptare sh.a, ky nen përcakton shkrehimisht: “*Çdo person që shkel dispozitat e këtij ligji dënohet me gjobë si më poshtë*”:..... b) *personi juridik nga 60.000 deri në 600.000 lekë*;.....”

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi arrin në konkluzionin se, Bashkia Fier është në shkelje të detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 33, pika 11, të Ligjit nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, shkelje e cila sipas nenit 33, pika 13, të po këtij ligji, është e dënueshme me gjobë.

Në lidhje me masën e gjobës, Komisioneri mban në konsideratë parashikimet dhe kriteret e vendosura në nenin 33, pika 12, të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku sanksionohet se: “12. Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës. Nëse vendoset gjobë, komisioneri përcakton shumën e gjobës duke marrë parasysh: i) natyrën dhe fushën e veprimit të shkeljes dhe ndikimin mbi viktimën; dhe ii) rrethanat personale e financiare të shkelësit, veçanërisht duke marrë në konsideratë të gjitha burimet e të ardhurave dhe nëse shkelja kryhet nga një person juridik privat, merren parasysh aktivet e bilancit dhe fitimi, si dhe pagat totale të paguara punonjësve; c) nëse e njëjta shkelje diskriminon disa persona, vendoset vetëm një gjobë, por duke marrë parasysh kërkesat e shkronjës “b” të këtij neni.”

Duke mbajtur në konsideratë kriteret e mësipërme për përcaktimin e masës së gjobës dhe bazuar në, natyrën dhe fushën e veprimit të shkeljes së konstatuar, e cila ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe ndikimin që ka shkelja e konstatuar tek ankuesi A. Z, i cili është i moshuar me aftësi të kufizuar në shikim; Komisioneri, arrin në përfundimin se, Bashkia Fier, duhet të gjobitet me 200 000 (dyqind mijë) lekë, për moszbatimin e vendimit nr.72, datë 15.05.2023.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “ç”, nenin 33, pika 11, 12 dhe 13, germa “b”, si dhe nenin 33/1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Bashkia Fier, të gjobitet në vlerën 200.000 (dyqind mijë) lekë, për moszbatimin e vendimit nr.72, datë 15.05.2023, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
2. Gjoha të paguhet në Buxhetin e Shtetit brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve nga marrja dijani.
3. Pagesa e gjobës të bëhet pranë çdo banke në llogarinë e thesarit Tiranë, për llogari të: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, NIPT: L02027451K, Kodi: 1091001, Entiteti i Qeverisjes: 001, Distrikti (TDO) 3535, Llogaria ekonomike: 7115499.
4. Zbatimi i vendimit nr.72, datë 15.05.2023, i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi, sjell shfuqizimin e gjobës.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA